



REPUBLIKA E KOSOVË
Drejtoria e Inspeksionit
Gllgoc, me 08.08.2018



RAPORT PËR MUAJIN KORRIK 2018

Gjatë këtij muaji me rëndësi të veçantë janë realizuar kontrolla të transportit publik, taksit legal dhe largimi i taksive ilegal si dhe kontrollë e ndërtimeve pa leje, ku me qëllim të mbikëqyerjes së vazhdueshme është kujdestaruar edhe gjatë vikendit në këto dy lëmi.

Në vazhdim po ju sjell punët e kryera nga secili Inspektor sipas lëmive të tyre përkatëse:

Inspektori i Ndërtimit gjatë këtij muaji ka bërë mbikëqyerjen inspektuese rreth ndërtimeve në përgjithsi. Është bërë ndërprerja e punimeve gjatë ndërtimit të disa objekteve pa leje duke zhvilluar të gjitha procedurat e nevojshme. Janë ekzekutuar tri vendime për largim të ndërtimeve nga prona publike në rr. Xhevat Demaku dhe Ilaz Kodra si dhe janë shqyrtuar 5 kërkesa të palëve.

Problem i pazgjedhur ka mbetur qështja e parcelen përball Parkut të Biznesit ku investitori Lulzim Krasniqi nuk e ka ekzekutuar aktvendimin nr 33/2018 më të cilin është urdhëruar që në afat prej 7 dite të hap shtratin e ujërrjedhes të cilin e ka mbyllë me deponimin e materialit inert me lartësi deri në 7m. I lartëcekuri aktvendimin e ka pranuar me dt. 02.07.2018 dhe ka pasur të drejtë ankese në MMPH në afat prej 15 dite. Këtë të drejtë përmes komunës së Drenasit nuk e ka shfrytëzuar ose nuk e ka njoftuar komunën e Drenasit për ushtrimin e një ankese të tillë. Pas kalimit të këtij afati përmes Kompanisë kontraktuese kemi filluar me hapjen e këtij kanali por nuk është përfunduar tërësisht.

Gjithashtu edhe këtë muaj ka qenë pjesë e Komisionit për:

- Vlerësim të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fakteqësive tjera ku janë kryer 3 raporte të vlerësimit ;
- Mbikëqyerje të projektit në rregullimin e rrethojave të shkolles në fshatin Gllobar dhe Baicë.

Inspektorët e Komunikacionit ka vazhduar me kontrolla të transportit rrugorë dhe largimin e transportuesve ilegal, e gjithashtu kontrolla të rendit të udhëtimit të Kompanive Transportuese të liçencuara. Gjatë kësaj periudhe janë bërë konfiskime të automjeteve dhe tabelave të tyre si dhe ka filluar em shqipëtimin e gjobave për transportuesit ilegal. Gjatë këtij muaji janë konfiskuar 19 automjete në kohëzgjatje prej 5 ditë dhe 11 palë tabela në kohëzgjatje prej 48 orë.

Inspektori i Tregut dhe Sanitar :me rëndësi të veçantë ka bërë largimin e tregtarëve që shesin jashtë lokacionit të tregut në rr.Fehmi dhe Xhevë Lladrovci dhe ata në sheshin “Fehmi Lladrovci” të cilët janë

larguar duke realizuar akcion me PK-njësi në Drenas. Gjithashtu është vazhduar me inspektim të reja rreth plotësimit të dokumentacionit për biznes.

Me kërkesen e Policisë, të cilët gjatë kontrollave të tyre rutinore kanë hasur në transport të dyshimt të artikujve ushqimorë, nga ana jonë është konfiskuar një sasi e mishit pa afat dhe disa artikujve të dyshimt në sasi rreth 80 kg të cilat janë asgjësuar përmes Kompanisë “Pastrimi” dhe është shqiptuar gjobë në vlerë prej 500 € ndaj shkelësit të Ligjit duke obliguar gjithashtu të paguaj shpenzimet e asgjësimit në vlerë 40 €.

Inspektori i Ambientit ka kryer inspektime të mjedisit në shqyrtim të kërkesave të palës, në veqanti inspektimin e bizneseve rreth hyrjes së tyre në sistem të menagjimit të mbeturinave. Gjithashtu janë inspektuar guroret që operojnë në Komune e Drenasit rreth ndotjes së mjedisit dhe kontrolles së dokumentacionit të tyre.

Në vazhdim është paraqitur pasqyra e punes në shifra për muajin Korrik 2018:

Lëmia Inspektuese	Procesverbale	Aktivendime	Gjoba mandatore	Kërkesa për Pëlqim sanitar	Pëlqime Sanitare	Kërkesa	Shqyrtim i kerk.	Konfiskim i targave dhe automjeteve	Konfiskim i mallit Të dyshimtë
I.Sanitare	04	2	2	2	2				
I.Tregut	16	2	1	1	1	1	1		80 kg
I.komunikacionit	36		1			1	1	11T,19A	
I.Ndërtimit	25	3				5	5		
I.Ambientit	20					4	4		
Totali	101	7	4	3	3	11	11	11+19	80 kg

Gusht 2018